



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
ADMINISTRATORI

Nr. 496 Prot

Durrës më 26.03.2019

**NJOFTIM
PËR ZGJATJE AFATI PËR APLIKIM**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 4 datë 25.01.2018 me Nr 6 Prot datë 25.01.2018 të Bordit të Administrimit të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, njoftimin me Nr. 342 Prot datë 25.02.2019, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës njofton të gjithë personat e interesuar për shprehje interesi për dhënien me qera ambjentit me sipërfaqe 11.5m² të ndodhur brenda Godinës Nr. 2 të Kampusit universitar" me adresë Lagjia Nr. 17, Spitalle, me objekt përdorimi "Kancelari", për një afat 12 muaj, se afati për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi shtyhet.

Personat e interesuar duhet të depozitojnë me postë drejtuar Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, **brenda datës 03.04.2019**, dokumentacionin origjinal ose të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbизнесin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Certifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin

***Shënim:** Në përcaktimin e ofertës subjektet e interesuar duhen të mbajnë parasysh tabelën "A" "Tarifat dysHEME të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

Duke iu falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR

GERALD ÇEKA

